

E DREJTA PËR INFORMIM



Lista e të dhënave të hapura të KDIMDP

Në zbatim të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" i cili është përafëruar pjesërisht me Direktivën (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka publikuar në faqen zyrtare listën e të dhënave të hapura që disponon si Autoritet Publik, subjekt i ligjit të mësipërm.

Lista e të dhënave të hapura përmban si më poshtë:

- Vendime/Rekomandime për të drejtën e informimit
- Raporte Monitorimi të Transparencës
- Për Autoritetin Publik
- Për Individin (Kërkesa) (Ankesa)
- Regjistri ankesave/Statistika, për të drejtën e informimit
- Newsletter
- Materiale Ndërgjegjëse/E drejta për informim
- Vendime/Rekomandime/Urdhra në fushën e mbrojtjes së të dhënave
- Transferimi Ndërkombëtar të të Dhënave
- Materiale Ndërgjegjëse/Mbrojtja e të dhënave personale
- Vendime/Për njoftimin dhe konsultimin publik
- Revista Informim Dhe Privatësi
- Raporte Vjetore të Zyrës së Komisionerit
- Strategji institucionale
- Plani i Integritetit 2022-2025

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 14 - Drejtorja
e Përgjithshme e
Tatimeve

Vendim Nr. 15 - Operatori
i Shpërndarjes së
Energjisë Elektrike

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit gusht 2024



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit gusht 2024, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me anë të vendimit nr. 14 datë 06.08.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve" (në vijim Autoriteti Publik), me objekt "Refuzim për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar pranë Autoritetit Publik t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni dhe konkretisht:

- Kopje e gjithë kontratave të marrjes me qira të pronave të paluajtshme nga ana e Autoritetit Publik në të gjithë vendin (ku Autoriteti Publik është në rolin e qiramarrësit).
- Kopje e gjithë kontratave të marrjes me qira të pronave të paluajtshme nga ana e Autoritetit Publik në të gjithë vendin (ku Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Publik janë në rolin e qiramarrësit).

Autoriteti Publik, i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke cituar: "Mbështetur në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, *Administrata Tatimore është e detyruar të ruajë të dhënat tregtare dhe personale të subjektit.*

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuari me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisionerit ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar. Në vijim, Autoriteti Publik ka konfirmuar edhe një herë qëndrimin e tij.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerësoi se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se:

"... *Administrata Tatimore është e detyruar të ruajë të dhënat tregtare dhe personale të subjektit...*", Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi kufizimi mbi dokumentacionin e kërkuar do duhet të bëhej bazuar në rastet e parashikuara në nenin 17 të LDI.

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, në mënyrë të tillë që të bënte dhe vlerësimin e interesit më të lartë publik.

Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me përdorimin e fondeve publike të shtetit shqiptar, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në këtë rast është i drejtpërdrejtë dhe i lartë.

Në rastin konkret, Autoriteti Publik, do të duhej të anonimizonte vetëm të dhënat personale të subjekteve qiradhënëse, në kontratat e kërkuara nga ankuesi. Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun <https://idp.al/vendime-2022/>, si Vendimi nr. 14, datë 13.05.2022, Vendimi nr. 40, datë 25.10.2022, etj. Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen "Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë", vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e "mbikëqyrësit shoqëror", duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI..

Takimi i 5-të i Komitetit Ekzekutiv të ICIC për 2024

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të ICIC u mbledhën në takim online të 5-të për të diskutuar çështje me rëndësi për të ardhmen e rrjetit. Në këtë takim, morën pjesë edhe anëtarët e rinj të zgjedhur në Konferencën e Tiranës në qershor. Prezent ishin autoriteti Meksikan, i cili u rizgjodh për një mandat tjetër 2024 - 2027 në krye të ICIC. Pjesëmarrës ishin autoritetet nga Argjentina, Bermuda, Sierra Leone, Shqipëria, Gjermania, Afrika e Jugut, Kenia, Bangladeshi dhe Australia.



Sekretariati i ICIC paraqiti rezultatet e pyetësorit të vlerësimit për edicionin e XV të Konferencës, e cila u zhvillua në Tiranë nga data 3 deri me 5 qershor 2024. Pjesëmarrësit në konferencë vlerësuan pozitivisht këtë edicion të organizuar nga Zyra e Komisionerit, si në aspektin logjistik dhe po ashtu në atë të përmbajtjes. Gjithashtu, Sekretariati prezantoi të gjitha sugjerimet e dhëna në sondazhin për prioritetet strategjike të rrjetit ICIC. Ky veprim u ndërmor pas diskutimeve të zhvilluara gjatë konferencës në Tiranë mbi të ardhmen e ICIC.

Anëtarët vijuan edhe me miratimin për pranimin e autoriteteve të reja që aplikuan për tu bërë anëtare në konferencë, konkretisht autoriteti i San Paulos dhe ai i Katalonjës. Gjithashtu, në cilësinë e organizatorit të ardhshëm të konferencës në 2025, autoriteti gjerman prezantoi disa nga masat e marra në kuadër të përgatitjeve për vitin e ardhshëm. Fokusi pritet të jetë në fushën e informacionit mjedisor dhe ndryshimit klimatik, ndërkohë që autoriteti gjerman së bashku me Sekretariatit kanë shpërndarë edhe një pyetësor me të gjithë anëtarësinë e ICIC për të mbledhur informacion nga vendet homologe lidhur me këtë temë. Në këtë kontekst, Sekretariati deklaroi se për edicionin e XVI do të ngrihet Komiteti i Planifikimit sikurse është bërë praktikë këto vitet e fundit.

Miratohet VKM nr. 444/2024 “Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe”

Në zbatim të Ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë hartoi projektvendimin “Për shtimin e të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe transportit publik”.

Me qëllim konsultimin e projektaktit dhe reflektimin e sugjerimeve, në datat 3 dhe 4 Prill u zhvilluan dy takime mes përfaqësuesve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke konsideruar dhe reлектuar dhe sugjerimet e Zyrës së Komisionerit si institucioni i ngarkuar për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Ky dokument u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 444 datë 03.07.2024 “Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe” dhe përputhet pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Europian 2023/138/BE, datë 21 dhjetor 2022, e cila përcakton një listë specifike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për publikimin dhe ripërdorimin e tyre, (*Celex 32023R0138, Commission Implementing Regulation (EU) 2023/138 of 21 December 2022 laying down a list of specific high-value datasets and the arrangements for their publication and re-use*).

Në të njëjtën kohë, vijon puna për identifikimin e të dhënave të hapura që organet e sektorit publik kanë në dokumentet ekzistuese ose që ato gjenerojnë si dhe publikimi i tyre sipas standardeve të kërkuara. Zyra e Komisionerit është fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit të Autoriteteve Publike, si një proces i rëndësishëm jo vetëm në aspektin teknik, por për vlerën e shtuar që do të sjellë në ekonomi zbatimi i këtij ligji.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:

